



NOTË KONCEPTUALE

LIGJI I RI PËR ARBITRAZHIN, NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË.

Datë: 19 Janar 2024

Vendi: Rogner Hotel "Room Antigonea 1"

Ky aktivitet organizohet nga Ministria e Drejtësisë dhe Universiteti i Tiranës, me asistencën e GIZ, bashkëpunimit Gjerman, si dhe ICC-në, me qëllim promovimin e mundësisë së zgjidhjes së mosmarrëveshjeve përmes arbitrazhit. Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin nr.52/2023 "Për arbitrazhin në Republikën e Shqipërisë", i cili synon krijimin e kuadrit ligjor për organizimin dhe zhvillimin e procedurave të arbitrazhit, si dhe garantimin e organizimit të zhvillimit të procedurave të arbitrazhit në mënyrë profesionale, cilësore, eficiente dhe efektive.

Me shfuqizimin e titullit të posaçëm mbi arbitrazhin në Kodin e Procedurës Civile në vitin 2013, lindi përgjegjësia e hartimit dhe miratimit të një ligji të posaçëm që do të rregullonte këtë fushë. Përcaktimi i rregullave kombëtare për zhvillimin e arbitrazhit është vlerësuar si një nga prioritetet e Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Drejtësisë, në drejtim të konsolidimit të shtetit të së drejtës, garantimit të të drejtave të njeriut, zgjidhjes e mosmarrëveshjeve dhe konflikteve midis shtetit dhe palëve private, apo palëve private me njëra-tjetrën, si dhe kundrejt detyrimeve të marra përsipër ndërkombëtarisht.

Ligji i ri është rezultat i një pune të gjatë dhe intensive disa vjeçare, i nisur me asistencën teknike të projektit "Konsolidimi i Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri" (EURALIUS V) dhe nëpërmjet tij krijohen për herë të parë institucionet e arbitrazhit, si dhe përcaktohen rregulla të qarta mbi organizimin e procedurave të arbitrazhit në Republikën e Shqipërisë.

Ligji për Arbitrazhin synon përmirësimin e procedurave të gjykimit dhe rritjen e efikasitetit në trajtimin e konflikteve, duke ofruar zgjidhje më të shpejtë të problemeve të krijuara, më efektive dhe më pak të kushtueshme, për të garantuar respektimin e të drejtave dhe lirive themelore, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare në këtë fushë.

Dispozitat e ligjit zbatohen për të gjitha procedurat e arbitrazhit vendas dhe ato të arbitrazhit ndërkombëtar, kur vendi i arbitrazhit është në territorin e Republikën e Shqipërisë. Procedura e arbitrazhit mund të organizohet nga një institucion i përhershëm arbitrazhi, sipas rregullave procedurale të tij dhe përcaktimeve të ligjit ose nëpërmjet arbitrazhit ad hoc.

Ligji për arbitrazhin pasqyron parimet dhe rregullat e përcaktuara nga Konventa e New York-ut, Konventa e Gjenevës, si dhe ligjit model të UNCITRAL duke qenë kështu në përputhje me standardet e përdorura në të gjithë botën.